

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6718
E enjte, 29 shtator 2022
çmimi 0.40 €

PE: Bisedimet e Serbisë me BE-në të kushtëzohen me sanksionet ndaj Rusisë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E KULTURËS (SBASHK) KËRKON MENDIMIN E ANËTARËSISË PËR PEZULLIMIN E GREVËS

SBASHK-u JEP SHENJA SE MËSIMI MUND TË NISË MË 3 TETOR



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS E KOSOVËS

Këshilli Grevist i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës u është drejtuar të mërkurën me një shpresë grevistëve, nga të cilët pret përgjigje nëse janë të pajtimit që mësimi të nisë më 3 tetor.

Këshilli Grevist në këtë shpresë ka propozuar pezullimin e grevës më së largu deri në janar të vitit 2023 dhe që grevistët t'i rikthehen mësimin nga data 3 tetor

AKTUALE



AKSION ANTI-DROGË NË DEÇAN DHE GJAKOVË, NARKOTIKËT E SEKUESTRUAR KAPIN VLERËN E 600 MIJË EUROVE

BE-JA KONFIRMON PËRKRAHJEN PËR KOSOVËN NË PROCESET INTEGRUESE


NJË DELEGACION NGA AUSTRIA VIZITON KOMUNËN E RAHOVECIT

EKONOMI



PUBLIKOHET RAPORTI "SHKATËRRIMI EKOLOGJIK, KOHA TË VEPROJMË"

SPORT



XHAKA: NUK I KEMI MESSIN DHE RONALDON, NE ARRIJMË VETËM NËSE PUNOJMË SË BASHKU



RASTI 'DEHARI', PEZULLOHET NGA PUNA KRYEINSPEKTORI YLBER TOPALLI

FAQE 5



BISLIMI: KOSOVA PRET ZHVILLIME POZITIVE SA I PËRKET LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Meloni: Ukraina mund të llogarisë në Italinë

ROMË, 28 SHTATOR - Ukraina mund të llogarisë në mbështetjen e qeverisë së re italiane, tha liderja e ekstremit të djathtë, Giorgia Meloni, në mesazhin dërguar presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky. "E dini se mund të llogarisni në mbështetjen tonë besnike në kauzën për lirinë e popullit ukrainas. Qëndroni të fortë dhe kini besim", ka shkruar Meloni në "Twitter".

Ajo iu përgjigj mesazhit urues të dërguar nga Zelensky, pasi partia e Melonit, Vëllezërit e Italisë, fitoi zgjedhjet e përgjithshme të së

dielës. "Ne vlerësojmë mbështetjen e vazhdueshme të Italisë për Ukrainën në luftën kundër agresionit rus. Ne llogarisim në partneritetin produktiv me qeverinë italiane", ka shkruar Zelensky në "Twitter". Kryeministri në largim i Italisë, Mario Draghi, ka qenë një prej mbështetësve më të fuqishëm të sanksioneve të Bashkimit Evropian kundër Ruisë për shkak të luftës në Ukrainë, pavarësisht se Italia ka varësi të madhe ndaj gazit rus.

Roma, po ashtu, ka dërguar armë për t'i ndihmuar Kievit që t'i

luftojë forcat e presidentit rus, Vladimir Putin.

Meloni është euroskeptike, por ka mbështetur qëndrimin e Draghit sa i përket Ukrainës - edhe pse aleatët e saj në koalicionin zgjedhor, lideri i partisë Liga, Matteo Salvini, dhe ish-kryeministri Silvio Berlusconi, kanë raporte të mira me Moskën.

Meloni pritet të bëhet kryeministrja e parë grua e Italisë dhe pritet ta udhëheqë një qeveri djathtiste, me prirjet më ekstreme që nga koha e Luftës së Dytë Botërore.



Uragani Ian lë pa rrymë Kubën

HAVANA, 28 SHTATOR - Kuba ka mbetur krejtësisht pa energji elektrike pasi Uragani Ian goditi pjesën perëndimore të ishullit, njoftoi Qeveria kubaneze.

Sistemi elektrik kolapsoi tërësisht, thanë zyrtarët, pasi një prej termocentraleve kryesore nuk mund të kthehej në funksion.

Dy persona raportohet se kanë vdekur dhe në mbarë vendin janë shkatërruar ndërtesa.

Uragani Ian është i kategorisë së tretë, me erëra që arrijnë shpejtësinë prej 195 kilometrash në orë. Tani Ian është nisur drejt Floridës së Shteteve të Bashkuara. Kreu i autoritetit për energji elektrike në Kubë tha për televizionin shtetëror se 11 milionë persona kanë mbetur pa energji elektrike pasi i tërë sistemi elektrik ka dalë jashtë funksionit. Pronari i kompanisë së njohur të cigareve Finca Robaina postoi fotografi në rrjetet sociale të shkatërrimit të shkaktuar nga uragani. "Është apokaliptike, një katastrofë e vërtetë", tha Hirochi Robaina.



Meteorologët kanë paralajmëruar se disa rajone të Kubës mund të përballen me 30 centimetra shi për shkak të uraganit Ian.

Presidenti i Kubës, Miguel Diaz Canel, ka vizituar provincat e prekura dhe është zotuar se shteti do t'i ndihmojë qytetarët. Uragani ka fituar forcë në Gjirin

e Meksikës, pasi është larguar nga Kuba, tha Qendra Kombëtare për Uragane e Shteteve të Bashkuara.

Të martën mbrëma stuhia kaloi përmes ishujve në jug të Floridës, teksa pritet që uragani të arrijë në bregun perëndimor të Floridës më vonë gjatë të

mërkurës.

Qendra Kombëtare për Uragane e ShBA-së tha se uragani Ian mund të bëhet stuhi e kategorisë së katërt kur ta godasë Floridën, me erëra të fuqishme. Rreth 2.5 milionë banorë në Floridë janë urdhëruar që të evakuhohen. Guvernatori i Floridës, Ron

DeSantis, paralajmëroi se uragani Ian do të jetë një stuhi e madhe, teksa shpalli gjendje të jashtëzakonshme në këtë shtet gjatë fundjavës. Po ashtu, ai urdhëroi aktivizimin e 5 000 trupave të Gardës Kombëtare.

Zona e Tampas do të mund të përballlet me goditjen e parë direkte nga një uragan që nga viti 1921, thanë zyrtarët, dhe valët e detit mund të arrijnë deri në tri metra lartësi.

Edhe shteti i Gjorgjias ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme dhe ka aktivizuar 500 trupa të Gardës Kombëtare.

Shtëpia e Bardhë, po ashtu, ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme, që do t'i ndihmojë shtetet dhe zyrtarët federalë të koordinohen për përpjekjet gjatë kësaj fatkeqësie natyrore, por do të ndihmojë edhe me dërgimin e ndihmave.

Teksa ShBA-ja po përgatitet për uraganin Ian, Karaibet po përballen me efektet shkatërruese të uraganit Fiona, që goditi këtë rajon javën e kaluar.

Princi Salman emërohet kryeministër i Arabisë Saudite

RIAD, 28 SHTATOR - Princi i fuqishëm i kurorës në Arabinë Saudite, Mohammed bin Salman, është emëruar kryeministër i shtetit, një pozitë që tradicionalisht i takon mbretit.

Princi Mohammed, i cili ka vite që konsiderohet udhëheqës de facto i shtetit, ka shërbyer më parë si zëvendëskryeministër nën Mbretin Salman si dhe si ministër i Mbrojtjes.

Pozitën e ministrit të Mbrojtjes e ka marrë tani vëllai i tij i vogël, Khalid bin Salman, i cili më parë ka qenë zëvendësministër i Mbrojtjes.

Ministritë e tjera të rëndësishme, përfshirë atë të Jashtme dhe të Energjisë, vazhdojnë të kenë udhëheqësit e njëjtë, sipas një

dekreti të Mbretit Salman, që është publikuar nga agjencia zyrtare e Arabisë Saudite.

Princi Mohammed, i cili ka mbushur 37 vjet këtë muaj, është i pari në linjë për ta marrë pozitën e mbretit. Ai është bërë ministër i Mbrojtjes më 2015, një hap i madh drejt konsolidimit të pushtetit.

Arabia Saudite nuk deklarohet publikisht rreth spekulimeve për shëndetin e Mbretit Salman, 86-vjeçar. Ai ka udhëhequr Arabinë Saudite - shtetin lider në botë për eksporte të naftës - prej vitit 2015. Më 2017 ai ka hedhur poshtë raportimet se planifikon ta abdikojë fronin ashtu që Princi Mohammed ta marrë pushtetin. Mbreti Salman është shtruar dy herë në spital këtë vit.



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E KULTURËS (SBASHK) KËRKON MENDIMIN E ANËTARËSISË PËR PEZULLIMIN E GREVËS

SBASHK-u jep shenja se mësimi mund të nisë më 3 tetor

Këshilli Grevist i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të mërkurën u është drejtuar me një shkresë grevistëve, nga të cilët pret përgjigje nëse janë të pajtimit që mësimi të nisë më 3 tetor. Këshilli Grevist në këtë shkresë ka propozuar pezullimin e grevës më së largu deri në janar të vitit 2023 dhe që grevistët t'i rikthehen mësimin nga data 3 tetor

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Këshilli Grevist i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës u është drejtuar me një shkresë grevistëve nga të cilët pret përgjigje nëse janë të pajtimit që mësimi të nisë më 3 tetor. "Këshilli Grevist i SBASHK-ut, bazuar në kontratën kolektive dhe sipas Ligjit për Grevën, dhe duke e analizuar ecurinë e grevës deri më tash, kërkon mendimin e anëtarësisë greviste që nga çerdhet e deri në universitete lidhur me idenë për pezullimin e grevës më së largu deri në janar 2023 dhe që grevistët t'i rikthehen mësimin që nga data 3 tetor 2022. SBASHK-u do t'i vazhdojë orvatjet që mësimdhënësve t'i rikthehet dinjiteti përmes dialogut social me qeverinë ashtu që të përmbushen kushtet themelore, të: 1) mbështetjes shtesë të pagës deri në zbatimin e Ligjit për Paga dhe sipas rritjes ekonomike përfshirë shkallën e inflacionit; 2) plotësim ndryshimit të Ligjit nr. 04/L 131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, për ta hequr kriterin e 15 vjetëve kontributdhënie; 3) plotësim-ndryshimi i Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore", thuhet në shkresën e Këshillit Grevist të SBASHK-ut.

Në këtë shkresë theksohet se në ditët e sotme mësimdhënësit janë nëpërkëmbur, dinjiteti u është cenuar, e ata historikisht janë të njohur për sakrificën e tyre përgjatë viteve. "Qeveria inatçore vazhdoi nëpërkëmbjen e mësimdhënësve, duke na quajtur jo vetëm analfabetë, por edhe 'të

shitur' të agjendave armiqësore, madje edhe vegla të partive opozitare, që është orvatje patetike dhe infantile. Qeveria tregoi se nuk e ka prioritet zhvillimin e arsimit përmes angazhimit cilësor dhe të dinjitetshëm të mësimdhënësve. Si rezultat i mungesës së dialogut të mirëfilltë social, kërkesës së sinqertë të këshillit të prindërve që mësimdhënësit të jenë bashkë me fëmijët dhe të nisë viti shkollor, për parandalimin e ndikimit të eksponentëve të qeverisë me agjendë përcarëse të kolektiveve shkollore dhe dyshimit tonë, se greva sikur po i duhet qeverisë për ta mbajtur vëmendjen e opinionit drejt grevës. Duke parë se pas gjithë përpjekjeve tona që të kemi dialog të mirëfilltë e të gjejmë zgjidhje të kërkesave legjitime, qeveria vazhdon qasjen e gabuar dhe pas angazhimit edhe të njerëzve me autoritet dhe ardhjes së drejtoreshës së përgjithshme të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) që ishte zë i grevistëve dhe solli kërkesa në emër të 11 milionë kolegëve nga e tërë Evropa që të realizohen kërkesat legjitime të grevistëve, por Kurti dhe qeveria vazhduan të dëshmojnë se nuk do ta zgjidhin kërkesat e grevistëve", është thënë në shkresën e Këshillit Grevist të SBASHK-ut.

KMDLNj: Nëse fillon mësimi SBASHK-u nuk do të jetë palë e humbur

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë sërish thirrje që të gjendet një zgjidhje për t'u ndërprerë greva në



arsim. "KMDLNj mendon se SBASHK-u e ka përmblytur detyrimin, në këtë rast moral ndaj anëtarësisë, mirëpo çdo vazhdim i mëtutjeshëm i grevës do t'i dobësojë pozicionet e SBASHK-ut aq më parë që dëmet e jashtëzakonshme që po i bëhen procesit arsimor, e tërë përgjegjësia po i adresohet SBASHK-ut e që nuk është e vërtetë. Me stërzgjatjen e grevës e cila është edhe kundër parashikimeve të SBASHK-ut, janë krijuar të gjitha kushtet që SBASHK-u të tregojë një vullneti të njëanshëm (kur mungon vullneti i qeverisë) dhe ta ndërpresë grevën. Nuk ka zgjidhje tjetër në këtë situatë!", ka theksuar KMDLNj. KMDLNj ka shtuar se ka reaguar kundër linçimit publik të orkestruar ndaj SBASHK-ut dhe kryetarit Rrahman Jasharaj si reagim nga pozita e të fortit e që është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut dhe praktikën e mira ndërkombëtare. "Nëse Qeveria e Kosovës ka qëndrim

linçues ndaj SBASHK-ut, e kjo është e pakundërshtueshme, edhe SBASHK-u mban përgjegjësi faktike dhe konkrete për shkelje të të drejtave të njeriut të nxënësve andaj duhet ta ndërpresë me shkelje të këtyre të drejtave. KMDLNj ka monitoruar protestat e organizuara në entet parashkollore dhe në disa shkolla dhe kërkesat e tyre i konsideron të drejta dhe të arsyeshme, hiç këtu angazhimet për grevëthyerje nga pozitë ekskluzivisht partiake. KMDLNj pret dhe shpreson se greva e SBASHK-ut do të përfundojë shpejt dhe do të nisë procesi arsimor", thuhet në komunikatën e KMDLNj-së, duke theksuar se në këtë rast SBASHK-u nuk do të jetë palë e humbur. "Nëse këmbëngul të vazhdojë këtë grevë në këtë mënyrë atëherë, pa asnjë dyshim më së shumti do të humbë SBASHK-u, përjashtuar nxënësit që edhe deri më tani janë humbësit më të mëdhenj, pa fajin e tyre", ka theksuar KMDLNj.

Viti shkollor në Kosovë nis më 1

shtator, por është gati fundi i muajit dhe mbi 300 000 nxënës ende mbeten jashtë bankave të klasës. Punonjësit e arsimit janë në grevë. Ata po kërkojnë mbështetje financiare prej 100 eurosh në muaj derisa të hyjë në fuqi Ligji për Paga. Qeveria e Kosovës thotë se ky ligj, që parasheh rritje pagash për punonjësit e sektorit publik, do të dalë në miratim së shpejti dhe kërkon nisjen e mësimin.

Liderët e partive opozitare sërish të martën e kanë kritikuar kryeministrin Kurti për grevën në arsim, duke e bërë fajtor për mosgjatjen e një zgjidhjeje për ta filluar mësimin.

Edhe myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, u ka bërë thirrje të punësuarve në arsim dhe shërbyesve civilë që ta ndërpresin grevën. Në një konferencë për medie mbajtur të martën, Tërnavë, teksa u ka bërë thirrje SBASHK-ut dhe Sindikatës së Shërbyesve Civilë për ndërprerje të grevës, Qeverisë së Kosovës i ka kërkuar që sa më parë ta miratojë Ligjin e Pagave.

Aksion anti-drogë në Deçan dhe Gjakovë, narkotikët e sekuestruar kapin vlerën e 600 mijë eurove



PRISHTINË, 28 SHTATOR - Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka dhënë hollësi lidhur me aksionin anti-drogë që ndodhi të mërkurën në rajonin e Dukagjinit, përkatësisht në komunat Deçan dhe Gjakovë. Sipas njoftimit për medie të Prokurorisë, thuhet se janë bastisur dhjetë lokacione në Deçan dhe Gjakovë, ku janë ndaluar me urdhër të Prokurorit të Shtetit shtatë persona të dyshuar për veprat penale: "Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së

kokainës apo kanabisit" dhe "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge". "Gjatë bastisjeve në komunën Gjakovë janë sekuestruara rreth 500 gramë narkotikë të dyshuar të llojit kokainë, ndërsa gjatë bastisjes në komunën e Deçanit në disa lokacione janë sekuestruar dhe asgjësuar rreth 180 bimë të mbjella të narkotikëve të llojit marihuanë, në sasi totale mbi 100 kilogramë. Gjithashtu, gjatë këtij aksioni janë

sekuestruar edhe armë, telefona, para kesh dhe prova të tjera materiale të cilat do shërbejnë për ndriçimin e kësaj çështjeje penale", thuhet në njoftim.

Prokuroria e Pejës ka njoftuar se vlera totale e drogës së sekuestruar dhe asgjësuar është më së paku 600 mijë euro. "Prokurori i shtetit brenda afatit ligjor kundër shtatë të pandehurve do ta paraqesë kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit në gjykatën kompetente", thuhet në njoftim.



PE: Bisedimet e Serbisë me BE-në të kushtëzohen me sanksionet ndaj Ruisisë

Parlamenti Evropian (PE) pritet të kërkojë që vazhdimi i bisedimeve të anëtarësimit në mes të Serbisë dhe Bashkimit Evropian (BE) të kushtëzohet me vendosjen e sanksioneve nga Beogradi ndaj Ruisisë. Kjo kërkesë është pjesë e një draft-raporti për strategjinë e zgjerimit të BE-së të përgatitur nga Tonino Piculla, deputet socialdemokrat nga Kroacia, i cili është raportues i PE-së për këtë strategji

BRUKSEL, 28 SHTATOR - Parlamenti Evropian (PE) pritet të kërkojë që vazhdimi i bisedimeve të anëtarësimit në mes të Serbisë dhe Bashkimit Evropian (BE) të kushtëzohet me vendosjen e sanksioneve nga Beogradi ndaj Ruisisë.

Kjo kërkesë është pjesë e një draft-raporti për strategjinë e zgjerimit të BE-së të përgatitur nga Tonino Piculla, deputet socialdemokrat nga Kroacia, i cili është raportues i PE-së për këtë strategji.

Në propozime, po ashtu, thuhet se duhet "të bëhet prioritet përshtatja e vendeve nga procesi i zgjerimit me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së dhe të vazhdohen negociatat e anëtarësimit me Serbinë, vetëm nëse ky vend u bashkohet

sanksioneve të BE-së ndaj Ruisisë". Serbia ka votuar disa rezoluta të Kombeve të Bashkuara që dënojnë pushtimin rus të Ukrainës, por deri më tani nuk u është bashkuar sanksioneve të bllokut evropian ndaj Moskës.

Edhe më herët PE-ja ka kërkuar nga Serbia që t'i vendosë sanksione Moskës, por në këtë draft-raport për herë të parë përmendet kushtëzimi i bisedimeve për anëtarësim me vendosjen e masave ndëshkuese ndaj Ruisisë, raporton REL.

Serbia, së bashku me Turqinë, janë shtetet e vetme që bëjnë pjesë në procesin e zgjerimit, që deri më tani nuk kanë mbështetur sanksionet e Perëndimit ndaj Ruisisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Ditët e fundit në disa qarqe të BE-së

është shprehur zhgënjim me sjelljen e Serbisë, pasi Beogradi javën e kaluar nënshkroi një marrëveshje për konsultime në fushën e politikës së jashtme me Federatën Ruse.

Edhe Shtetet e Bashkuara shprehën shqetësim për këtë marrëveshje, teksa ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, tha se në kohën kur pushtimi i Ukrainës po vazhdon, askush nuk do të duhej "të nënshkruante diçka me Rusinë". Por, Serbia ka thënë se një marrëveshje të tillë, Ministria e Jashtme serbe ka nënshkruar me Rusinë që nga viti 1996 çdo dy vjet. Në draft-raportin e PE-së, për të cilin do të debatohet në tetor në Komisionin e Politikës së Jashtme, kërkohet që sa më shpejt të përmbyllet liberalizimi i vizave për Kosovën.

Po në tetor Këshilli Evropian ka vendosur në agjendë çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. Sipas dokumentit, kërkohet që BE-ja të angazhohet më shumë me autoritetet e Kosovës dhe Serbisë që përmes dialogut të ndërmjetësuar nga blloku, shtetet të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjrisht të obligueshme për normalizimin e raporteve.

Aty, po ashtu, theksohet mbështetja për aspiratat evropiane

të shteteve të Ballkanit Perëndimor, por edhe për Ukrainën, Moldavinë dhe Gjeorgjinë.

Përmes dokumentit të përgatitur nga PE-ja bëhet thirrje që "të përshpejtohet procesi i integritetit i atyre vendeve që dëshmojnë orientim strategjik dhe përkushtim të palëkundur ndaj reformave evropiane, konsolidim të demokracisë dhe harmonizim me politikën e jashtme të BE-së".

PE-ja kërkon që të shpërblehet përparimi i shteteve kandidate që kanë harmonizuar politikën e tyre me ato të BE-së dhe të sanksionohet çdo regres. "Duhet siguruar që hapat e përkohshëm të integritetit të mos e zëvendësojnë, por ta ndihmojnë qëllimin përfundimtar që duhet të jetë anëtarësimi i plotë në BE", thuhet në draft-raport.

Dokumenti i hartuar nga raportuesi Piculla kërkon që të pezullohet procesi i negociatave të anëtarësimit mes BE-së dhe Turqisë në përputhje me kornizën negociuese derisa Ankaraja të mos angazhohet përsëri me Brukselin dhe të dëshmojë përparim të qartë në reforma. Por, Parlamenti Evropian kërkon që me Turqinë të ketë "partneritet thelbësor në fushat e interesit të

përbashkët".

Strategjia e zgjerimit, sipas PE-së, duhet të propozojë edhe një "partneritet të posaçëm" me ato shtete që nuk kanë qëllim të anëtarësohen në bllokun evropian apo nuk përmbyshin kriteret për anëtarësim.

PE-ja, po ashtu, përsërit se procesi i zgjerimit duhet të jetë një proces ku secili shtet vlerësohet në bazë të meritave individuale në të cilin mbetet në fuqi politika e kushtëzimit. Ky kushtëzim duhet të përqendrohet sidomos në respektimin e parimeve të demokracisë, pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe lirinë e medieve.

Prej gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor, vetëm Serbia dhe Mali i Zi janë më të avancuar në procesin e anëtarësimit. Këto dy shtete kanë hapur disa kapituj në procesin e negociatave të anëtarësimit. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria këtë vit kanë hapur procesin e bisedimeve, ndërsaq Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina mbeten të fundit në rajon në rrugën e tyre drejt BE-së, pasi asnjëra prej tyre nuk e kanë marrë ende statusin e vendit kandidat.

Rasti “Dehari”, pezullohet nga puna kryeinspektori Ylber Topalli

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se mbi bazën e gjetjeve në raportin e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, të mërkurën Komisioni Disiplinor ka marrë vendim për pezullimin nga puna të kryeinspektorit të Inspektoratit, Ylber Topalli.

Topalli është pezulluar nga puna për pretendimet e shkeljeve të rënda procedurale që janë të ndërlidhura me rastin e Astrit Deharit. “Procedura disiplinore ndaj z. Topalli është iniciuar për pretendimet e shkeljeve të rënda procedurale që janë të

ndërlidhura me rastin e ngjarjes së Astrit Deharit, që kishte ndërruar jetë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor 2016. Me këtë rast, pas konstatimit të gjetjeve të raportit, të cilat i kemi proceduar edhe në Prokurori të Shtetit, bëjmë thirrje dhe theksojmë nevojën e vazhimit të procedurave hetimore për trajtimin e mëtutjeshëm të të gjitha rrethanave deri në zbardhjen përfundimtare të këtij rasti”, ka njoftuar Ministria e Drejtësisë.

Edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës ka pezulluar nga puna dy zyrtarë të lartë për, siç thuhet, shkelje të rëndë lidhur me

mosveprimet në rastin e ngjarjes së rëndë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, të vitit 2016, kur më 5 nëntor 2016 u gjet i vdekur Astrit Dehari.

Në komunikatë thuhet se “Shërbimi Korrektues i Kosovës njofton opinionin se ka pezulluar nga puna z. Burim Buleshkaj, ish-u. d. drejtor i Departamentit për Operativë Siguri dhe Transport të të Burgosurve në ShKK, aktualisht udhëheqës për Administratë në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, si dhe z. Destan Zogaj, zyrtar korrektues, ish-u.d. drejtor në Qendrën e Paraburgimit Prizren. Ndaj tyre është iniciuar procedurë

disiplinore për shkelje të rëndë lidhur me veprimet, mosveprimet në rastin e ngjarjes së rëndë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren të vitit 2016”, thuhet në njoftim.

Më tej thuhet se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka vlerësuar se ushtrimi i detyrës në funksionet të cilat i kanë, pengon hetimin disiplinor apo mund ta cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës. “Andaj, Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës vendos pezullimin e nëpunësve civilë, për të vazhduar tutje me procedurat hetimore dhe të rishqyrtimit të të gjitha

rrethanave lidhur me ngjarjen dhe përgjegjësitë”, thuhet në njoftim.

Më 5 nëntor të vitit 2016, në orët e para të mbrëmjes, u raportua për një vdekje të një personi brenda Qendrës së Paraburgimit në Prizren. Vetëm pak minuta më pas u raportua se brenda qelisë së tij ishte gjetur i vdekur ish-aktivisti i LV-së, Astrit Dehari, i cili aty po qëndronte nën dyshimet se ka qenë një nga gjashtë personat që mori pjesë në sulmin e gushtit të po atij viti me granatahedhëse në Kuvendin e Kosovës. Vdekja e Astrit Deharit menjëherë u cilësua si e dyshimtë, ndërsa u kërkua që ndaj tij të bëhej edhe autopsia nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.



Përurohet projekti për rregullimin e parkut në fshatin Gjyrkoc të Shtimes

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, është pritur në takim nga kryetari i komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, me të cilin kanë diskutuar për zhvillimin

ekonomik lokal, bashkëpunimin në mes të qeverisë dhe komunës si dhe mbarëvajtjen e proceseve të projekteve komunale. Ministri Krasniqi dhe kryetari Aliu kanë vizituar zyrat e

administratës komunale, e cila po vazhdon ofrimin e shërbimeve për qytetarët në mënyrë të rregullt. Gjithashtu, ministri Krasniqi dhe kryetari Aliu së bashku me banorët e fshatit kanë

përuar projektin "Rregullimi i parkut dhe këndit të lodrave në lagjen e komuniteteve në fshatin Gjyrkoc", financuar nga programi për mbështetje për projekte infrastrukturore për komunitete.



Një delegacion nga Austria viziton komunën e Rahovecit



RAHOVEC, 28 SHTATOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger, kryetarin e Kuvendit të Austrisë së Ulët, Karl Wilfing, nënkryetarin Karl Moser dhe bashkëpunëtorët e tyre që ishin pjesë e këtij delegacioni.

Ambasadorit Weidinger dhe bashkëpunëtorëve të tij kryetari Latifi u ka uruar mirëseardhje si dhe i ka falënderuar për mbështetjen që Austria i ka dhënë në vazhdimësi Kosovës. "Gjithashtu, i njoftova për aktivitetet dhe planet e komunës së Rahovecit dhe shpreha gatishmërinë për thellimin e

bashkëpunimit të ndërsjellë. Gjatë takimit bashkëbiseduam edhe për vlerat kulturore e turistike që ofron komuna jonë dhe për potencialet tona zhvillimore. Me theks të veçantë, bashkëbiseduam për mundësitë e vendosjes së urave të bashkëpunimit në të gjitha fushat, për t'i promovuar dhe shkëmbyer prodhimet tona bujqësore, në

veçanti prodhimet e rrushit, verës, pemëve e perimeve", ka bërë me dije Latifi. Më pas kryetari Latifi dhe delegacioni nga Austria vizituan verarinë "Bodrumi i Vjetër" të pronarit Ruzhdi Haxhijaha, një shembull i mirë për ndërmarrësi dhe zhvillim biznesi në Rahovec dhe Kosovë.

Në fund të vizitës, kryetari Latifi ka falënderuar ambasadorin Weidinger dhe bashkëpunëtorët e tij dhe janë pajtuar për gjetjen e mundësive të reja të bashkëpunimit, për t'i fuqizuar tutje marrëdhëniet ndërmjet Rahovecit dhe Landit të Austrisë së Ulët (Landtag von Niederösterreich).

Fillojnë punimet restauruese në xhaminë e Osman Efendisë

Novobërdë, 28 shtator - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, bashkë me partnerët nga zyra e BE-së dhe UNDP-së, ishin në vizitë në Novobërdë, ku kanë filluar punimet restauruese në xhaminë e Osman Efendisë. Këtë vizitë e zhvilluan në muajin që shënohen ditët e trashëgimisë evropiane dhe kur festohet trashëgimia e qëndrueshme, ndërsa takuan studentët e arkitekturës dhe të trashëgimisë kulturore që janë pjesë e kampit të restaurimit, të cilët po mësojnë teknikat e ruajtjes dhe

restaurimit përmes mësimin teorik dhe duke e aplikuar në praktikë. Ndërhyrjet restauruese po bëhen në kuadër të programit "Trashëgimia kulturore si nxitëse e dialogut ndërmjet komuniteteve dhe kohezionit social", bashkëpunim mes Ministrisë së Kulturës, Bashkimit Evropian dhe UNDP-së, ndërsa po zbatohet nga organizata "Trashëgimia Kulturore pa Kufij". Në kuadër të këtij programi parashihet restaurimi i dhjetëra aseteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës.



Vetëm një rast me Covid në 24 orët e fundit

Prishtinë, 28 shtator - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 111

testimeve, është konfirmuar vetëm një rast me Covid-19. Sipas këtij raporti të MSH-së,

janë shëruar katër persona nga ky virus. Raste aktive janë 41.

Gjatë 24 orëve të fundit 29 persona kanë marrë vaksinën kundër Covidit.



Të rinjtë e AAK-së kërkojnë plotësimin e kërkesave të SBASHK-ut

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Aleanca e të Rinjve e Kosovës ka zhvilluar të mërkurën një aksion simbolik para Ministrisë së Arsimit në mbështetje të kërkesave të mësimdhënësve.

Ata kanë vendosur para ministrisë një pankartë me Abetaren e përbashkët Kosovë - Shqipëri që filloi të përdoret nga ky vit shkollor. "Kryeministri me kryeneçësi dhe indiferencë vazhdon t'i

përbuzë mësueset dhe mësuesit. Kjo është një tjetër dëshmi që ky kryeministër nuk është i interesuar që të reflektojë mbi atë për çka është zgjedhur", ka thënë Visar Dili, nënkryetar i të rinjve të AAK-së.



Bislimi: Kosova pret zhvillime pozitive sa i përket liberalizimit të vizave

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka marrë pjesë në "Konferencën rajonale të misionëve norvegjeze në Evropën Juglindore". Në fjalën e tij Bislimi ka thënë se Kosova është e orientuar drejt një zhvillimi gjithëpërfshirës. "Agjenda evropiane për këtë vit është ambicioze, ku shënojmë një vit të rëndësishëm pas aplikimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe synimit për aplikim për anëtarësim në

BE brenda këtij viti. Liberalizimi i vizave është një çështje që po trajtohet me përparësi dhe po punohet për të pasur zhvillime pozitive dhe dinamike të re në këtë çështje, për të cilën Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret dhe po punon ngushtë me shtetet anëtare të BE-së", ka thënë Bislimi. Gjithashtu, ai ka thënë se gjatë vitit të fundit është shënuar përparimi më i madh dhe i rëndësishëm në implementimin e reformave në fusha kyçe në kuadër të agjendës evropiane, kur jemi tashmë në vitin e gjashtë të implementimit të Marrëveshjes

së Stabilizim Asocimit. "Kosova është gati për sfida të reja, hapja të mëtejme dhe status më të avancuar në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian. Avancimi që ka njohur Kosova ka shfaqur potencialin tonë për shtrirje më të gjerë të trajektoreve sonë të zhvillimit përtej barrierave ekzistuese. Vendi ka njohur rritje me 17 pozicione në indeksin e Transparency International e, po ashtu, 17 vende në indeksin e lirisë së medias, World Freedom. Ndërkohë, sipas World Justice Project, për vlerësimin e sundimit të ligjit, Kosova është e 60-ta në botë dhe e para ndër

gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor", ka pohuar ai. Bislimi ka theksuar se vendi ynë po përballet me sfida të përbashkëta me vendet e tjera të BE-së dhe kontinentit evropian, siç është kriza e energjisë, si efekt i krijuar nga agresioni i pajustificuar rus në Ukrainë. "Qeveria ka marrë masa për lehtësimin e krizës energjetike ku dhe janë ndarë në total përgjatë vitit mbi 100 milionë euro për subvencionim të energjisë elektrike me synim për ta ulur ndikimin e rritjes së tarifave të konsumatorit si dhe, së fundmi, 6 milionë euro për zbatim të masave të efikasitetit

së energjisë", ka deklaruar zëvendëskryeministri Bislimi. Sa i përket dialogut me Serbinë, u theksua veçanërisht se Kosova është palë aktive dhe konstruktive, e përkushtuar për arritjen e një marrëveshjeje të përhershme, ligjërisht të obligueshme, me në qendër njohjen reciproke. Zëvendëskryeministri Bislimi ka falënderuar ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grøndahl, si dhe përfaqësuesit nga misionet norvegjeze në Evropën Juglindore për mikpritjen dhe diskutimin e frytshëm të zhvilluar në kuadër të konferencës.

BE-ja konfirmon përkrahjen për Kosovën në proceset integruese

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion nga Bashkimi Evropian, kryesuar nga Vassilis Maragos, shef i Njesisë për Kosovë në Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit. Konjufca ka vlerësuar marrëdhëniet e mira midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës teksa ka shprehur mirënjohje për mbështetjen që BE-ja i ka dhënë legjislativitet me fonde dhe projekte të ndryshme zhvil-

limore që nga paslufta. "Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Bashkimi Evropian kanë ndërtuar tashmë një traditë të mirë bashkëpunimi si rezultat i të cilit janë shënuar shumë arritje në fushën e demokracisë sonë parlamentare", ka theksuar Konjufca, duke shpalosur përparimin e arritur, sfidat dhe prioritetet e legjislativitet. Shefi i Njesisë për Kosovë, Maragos, ka shprehur gatishmërinë e BE-së për vazhdimin e mbështetjes së institucioneve të Kosovës, përfshirë edhe Kuvendin, në reformat e plani-

fikuara që lidhen me integrimin në BE dhe anëtarësimin në organizata të tjera ndërkombëtare. Kryetari i Kuvendit dhe zyrtarët e Bashkimit Evropian u pajtuan për fuqizimin e mëtejme të partneritetit dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh në funksion të miratimit të ligjeve sa më cilësore dhe në pajtueshmëri të plotë me standardet e BE-së. Pjesë e takimit të sotëm ishin edhe përfaqësuesit e lartë të BE-së në Kosovë, Johannes Madsen Stenbaek, Alessandro Bianciardi, Annemarie Douwes dhe Nicola Scaramuzzo.



Publikohet raporti 'Shkatërrimi ekologjik, koha të veprimjme'

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Koalicioni 27, grupi i organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e mjedisit, u ka bërë thirrje institucioneve qeveritare të veprojnë menjëherë me hapa konkretë për përmirësimin e gjendjes mjedisore dhe përmirësimin të shëndetit publik. Në këtë aspekt është rekomanduar të merren vendime për uljen e emetimeve të gazrave serë, përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, kufizimin ose ndalimin e plotë të përdorimit të qeseve plastike, mbrojtjen rigoroze të akumulacioneve që shfrytëzohen për ujë të pijshëm, si dhe për menaxhimin e ndryshimeve klimatike. Rekomandimet u bënë gjatë publikimit të raportit "Shkatërrimi ekologjik, koha të veprimjme", që paraqet gjendjen e mjedisit në Kosovë në raport me kërkesat e Bashkimit Evropian në kapitullin 27 "Mjedisi dhe ndryshimet

klimatike".

Raporti, i pari i llojit të tillë i përgatitur në Kosovë, mbulon pesë tematika kryesore: ndotjen e ujit, ndotjen e ajrit, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen e pyjeve dhe ndryshimet klimatike.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se mbrojtja e mjedisit nuk ka qenë prioritet i asnjërës prej qeverive dhe se ka shumë sfida dhe ngecje serioze në secilën fushë. "Meqenëse Kosova aspirojnë anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian dhe është nënshkruar Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit dhe Marrëveshjes së Gjellbër, ajo do të duhej t'i merrte përsipër edhe obligimet që dalin nga këto marrëveshje. Këto kritere kanë të bëjnë kryesisht me reforma dhe përafrim të legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian dhe ndërmarrjen e masave për t'i ngritur kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit", ka thënë gjatë publikimit të raportit Krenare Salihu nga Koalicioni 27.

Raporti analizon gjendjen e përgjithshme, legjislacionin



dhe zbatimin e tij, strategjitë dhe planet, problemet

kryesore, kapacitetin institucional dhe në fund jep

disa rekomandime për t'i adresuar problematikat.

Kuvendi për gjashtë muaj shpenzoi mbi 3.4 milionë euro për paga



PRISHTINË, 28 SHTATOR - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka votuar raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2022.

Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka shpalosur para deputetëve raportin e shpenzimeve për gjashtëmuajorin e parë të këtij viti, duke sqaruar se mbi 3.4 milionë euro janë shpenzuar për paga dhe mëditje. "Kategoria e pagave në buxhetin gjashtëmuajor është 3.401.375,91 euro dhe, si të tilla, janë të ndara në katër programe: për anëtarët e Kuvendit janë shpenzuar 1.807.264,22 euro, nga Administrata e Kuvendit 1.072.677,71 euro e për stafin mbështetës politik 504.947,45 euro. Shpenzimet komunale

janë alokuar me 200 mijë euro dhe këto fonde janë shpenzuar vetëm 105.255,55 euro ose 52.63 për qind e buxhetit të ndarë", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka dhënë vlerësim kritik për planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Ai ka pyetur se si është e mundur që buxheti për vitin paraprak nuk është shpenzuar në tërësi. "Nëse shkojmë tek investimet kapitale keni kërkuar buxhet për vitin e kaluar 500 mijë euro, ndërsa shpenzueshmëria është 52 për qind. Pra nëse e shohim planifikimin për vitin pasues, keni kërkuar buxhet 640 mijë euro", ka thënë Lekaj.

Më tutje, deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka kërkuar një listë me emra të të punësuarve si këshilltarë dhe persona të tjerë të angazhuar në këtë institucion.

Hoti: Trendi i rritjes ekonomike është në rënie

Prishtinë, 28 shtator - Avdullah Hoti ka bërë me dije se në qeverinë e udhëhequr nga ai ka punuar shumë për të nxjerrë ekonominë nga kriza për shkak të pandemisë. "E kthejmë trendin pozitiv që në muajt e parë të vitit 2021. E dorëzuar mandatin me rritje pozitive ekonomike,

me baza të mira për të vazhduar më tutje. Që nga atëherë trendi i rritjes ekonomike është në rënie", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka shtuar se sigurisht shkaktarë janë edhe faktorët e jashtëm, por thotë se në politika ekonomike dhe fiskale nuk është ndërmarrë

asnjë veprim domethënës. "Qeveria është mbyllur plotësisht ndaj bizneseve. Nuk është mbajtur asnjë mbledhje e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik për të diskutuar për shqetësimet e bizneseve dhe për t'i zhvilluar politikat e reja ekonomike", ka deklaruar Hoti.



Leksione të rëndësishme për t'u mësuar nga Anna Delvey



Me serialin më të fundi të "Netflix", nuk ka asnjë njeri që të mos e ketë dëgjuar emrin e Anna Delvey. Unë dëgjova për herë të parë për të disa vite më parë. Trashëgimtarja e rreme e aristokracisë gjermane, arriti të përvetësojë përmes mashtrimit mijëra dollarë nga elita e Amerikës.

Ndërsa nuk i mbështes metodat e saj për të fituar para, nuk mund të mos pyesja veten se si ia doli të arrinte synimet e saj për aq kohë sa zgjati ky mashtrim. Por, më shumë se kaq, më bëri shumë përshtypje besimi që ajo kishte tek vetja.

Sukses apo dështim

Siç e shihni, sistemi ynë i besimit është faktori kryesor nëse kemi sukses apo dështojmë në përpjekjet tona dhe në jetë në përgjithësi. Pasi kalova vitet e fundit duke trajnuar klientët se si të kapërcenin besimin e tyre të dobët tek vetja, dhe të shfrytëzonin fuqinë e mendjes së tyre, nuk ishte çudi që kur u futa më thellë në historinë e Anna Delvey, kuptova se ajo kishte një qasje të ngjashme për të arritur atje ku donte. Unë nuk kam ndërmend të krijoj

një grup kriminal për të arritur qëllimet e tij në jetë, duke u angazhuar në aktivitete të paligjshme. Por merita i takon Anna Delvey, pasi ajo kishte besimin dhe sistemin e besimit, që shumica e njerëzve vetëm mund ta ëndërrojnë.

Besoni tek vetja

Nëse doni të arrini qëllimet tuaja, duhet që të besoni tek vetja tuaj. Një individ që i vendos një qëllim vetes, dhe më pas heq dorë që pas disfatës së parë, është ai që nuk e ka ende sistemin e tij të besimit. Besimi tek vetja është hapi i parë për të pasur sukses dhe për të pasur jetën që ëndërroni. Shumë vite më parë, kur isha i sapodiplomuar, doja të gjeja një punë në fushën që kisha studiuar. Dhe si shumë studentë të tjerë, u detyrova të nisja punë në një call-center përshërbimin ndaj klientit për të paguar shpenzimet e mia, derisa të mund të angazhohesha në profesionin tim. Dita ime përfshinte dëgjimin në telefon të njerëzve të bezdisshëm që ankoheshin për gjithçka. Madje mbaj mend një ditë një zonjë që

mori në telefon, duke dashur të ankohej për zhurmën e disa fëmijëve që luanin në oborrin e shtëpisë së tyre. E kush e bën këtë?

Mos e humbni besimin tek synimet tuaja

Ndërsa roli në të cilin punoja mund të më kishte vënë në dyshim ekzistencën time, unë u fokusova tek synimet e mia më të mëdha. Unë kisha besim në aftësinë time për të arritur atje ku duhej të isha, dhe e dija se do të arrija destinacionin tim. E njëjta gjë vlen edhe për ju.

Mos lejoni që një disfatë e përkohshme të shkatërrojë besimin tuaj apo të vërë në dyshim aftësitë tuaja.

Për sa kohë që përqendrohni tek rezultati përfundimtar dhe besoni tek aftësitë tuaja, do të arrini atje ku duhet të jeni. T.Harv.Eker ka thënë: "Njerëzit e suksesshëm kanë frikë, njerëzit e suksesshëm kanë dyshime, dhe njerëzit e suksesshëm kanë shqetësime. Dallimi është se ata nuk i lejojnë këto ndjenja që t'i pengojnë në arritjen e qëllimeve të tyre".

Lëreni mënjanë frikën tuaj

Një tjetër pengesë për të pasur një sistem të fortë besimi dhe për të pasur sukses është frika. Frika është origjina e të gjitha dështimeve, dhe ajo që e pengon një individ të arrijë synimet e tij. Frika se mos bëni një gabim, se mos ndoshta nuk dini diçka. Lista e frikërave është e pafundme, por koha juaj jo.

Riçard Branson thotë: Nëse dikush ju ofron një mundësi të mahnitshme dhe nuk jeni të sigurt se mund ta bëni, thoni po, dhe mësoni më vonë se si ta realizoni. Dhe në fakt ka të drejtë. Mos lejoni që frika të kufizojë mundësinë tuaj për t'u rritur. Nëse zgjidhni të hiqni dorë nga frika që ju pengon, dhe të hidhni një hap përpara plot besim, atëherë në dispozicion do të kenimundësi të pafundme.

Mos lejoni që t'ju kontrollojnë mendimet e të tjerëve

Të gjithë kanë një mendim për dikë a diçka. Ju mund të keni edhe një mendim për mua nga artikujt që

unë shkruaj. Sido që të jetë, është thelbësore të vendosni kufij të shëndetshëm me ata që ndodhen përreth jush, përfshirë personazhet pa fytyrë në mediat sociale në rast se jeni i ekspozuar në sytë e publikut.

Mësoni se opinionet që të tjerët kanë për ju, janë të ndërtuara mbi imazhin që ata kanë krijuar për ju në mendjet e tyre. Pra ju nuk mund të kontrolloni se çfarë mund të mendojë një individ për ju, por mund të kontrolloni opinionet që keni për veten tuaj!

Pra, ashtu si nuk do të pinit helm dhe ta lejonit atë në trupin tuaj, mos lejoni që mendimet negative të të tjerëve të depërtojnë në mendjen tuaj. Ju duhet të përqendrohni tek mendimi që keni mbi veten dhe atë që mund ta arrini.

Ju mund të arrini gjëra të mëdha vetëm nëse keni një sistem të fortë besimi. Një gjë është e sigurt, e doni apo urreni "Anna Delvey", leksioni i vetëm që mund të nxirri nga ky serial, është se si mund t'i realizoni qëllimet tuaja duke pasur një besim të fortë tek vetja dhe bindjet tuaja. / Filiz Behaettin (A2S) – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Dy lojtarë të Kosovës në formacionin e Ligës së Kombeve

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës të martën në mbrëmje e mposhti Qipron me rezultat 5-1. Vedat Muriqi ishte i pandalshëm në këtë ndeshje me dy gola të realizuara, kurse një gol

shumë të bukur e shënoi Florent Muslija. Këta dy futbollistë për paraqitjen e mirë janë shpërblyer nga UEFA, e cila i ka përfshirë ata në 11-shen ideale të xhiros së fundit të fazës së grupeve të

këtij edicioni në Ligën e Kombeve. Sulmuesi i Mallorcas është vlerësuar me notën 8.9, e dyta më e mirë nga krejt ekipi, kurse mesfushori kreativ u vlerësua me 8.7. Në këtë ekip

bëjnë pjesë edhe yjet e futbollit si Van Dijk dhe Christian Eriksen. Formacioni (3-4-1-2): Schmeichel, Mets, Antov, Van Dijk, Coufal, Rata, Muslija, Brady, Eriksen, Puskas, Muriqi.



Khaka: Nuk i kemi Messin dhe Ronaldon, ne arrijmë vetëm nëse punojmë së bashku

CYRIH, 28 SHTATOR - Granit Xhaka festoi ditëlindjen e tij me fitoren që Kombëtarja e Zvicrës e arriti përballë asaj çeke me rezultat 2-1. Mesfushori Granit Xhaka është shprehur i kënaqur me fitoren e arritur, por edhe me tri fitoret e arritura radhazi në ndeshjet e fundit të Ligës së Kombeve. "Ne fituam tri pikë dhe luajtëm tri ndeshjet e fundit ashtu siç e kishim parashikuar të gjithë ciklin. Mund të krenohemi me këto arritje. E dinim që ndeshja me Çekinë do të ishte ndryshe nga ajo me Spanjën, sepse kishim më shumë hapësirë për të luajtur. Ndoshta jo në çdo moment për momentin dukej bukur, por kjo nuk ka rëndësi. Ne treguam se mund të luajmë keq dhe ta sjellim fitoren. Është shumë e vështirë të luash kundër nesh", ka thënë Xhaka.

Fillimi në Ligën e Kombeve nuk ishte i mirë, sidomos pas tri humbjeve radhazi. "Nëse fitoni ndaj Spanjës dhe Republikës Çeke, ju keni bërë përparim. Ne treguam një reagim pas një fillimi të keq. Në katër ndeshjet e fundit ne treguam se çfarë pritet nga kombëtarja dhe çfarë presim nga vetja. Prandaj unë nuk jam i befasuar që fituam tri ndeshje radhazi", ka shtuar Xhaka, i cili ka treguar se shumë gjëra kanë ndryshuar në kombëtare në periudhën e kaluar. "Kemi punuar nën drejtimin e Petkoviçit për



shtatë vjet. Ai kishte një filozofi të ndryshme nga Yakin. Na duhej kohë, edhe pse u kualifikuam në Kupën e Botës kundër Italisë në vjeshtë. Por edhe atëherë ishim me fat me dy penallti të humbura. Ne

luftojmë për secilën ndeshje shumë më tepër se më parë. Ne nuk kemi Messin dhe Ronaldon në ekip, ne arrijmë vetëm nëse punojmë së bashku. Këtë e kemi parë në vitet e mëparshme", ka deklaruar Xhaka.

Zvicra do të luajë në Kupën e Botës me Brazilin, Serbinë dhe Kamerunin. Xhaka thotë se skuadra do të ketë diçka për të treguar në Katar. "Gjashtë pikë nga dy ndeshje na japin shumë besim. Ata që më

njohin e dinë se kam pritshmëri të mëdha për veten dhe ekipin. Mund të ëndërroj, edhe për diçka vërtet të madhe. Por ne po ecim ngadalë, hap pas hapi", ka përfunduar Xhaka.



Ballkani mposhti Malishevën

MALISHEVË, 28 SHTATOR - Skuadra e Ballkanit e mposhti Malishevën me rezultat 3-2 në ndeshjen e mbetur të javës së parë në Superligën e Kosovës në futboll. Malisheva befasoi kampionët në minutën e parë të ndeshjes duke shënuar nëpërmjet Agon Xhakës për 1-0, por Ballkani u rikthye në

lojë në fund të pjesës së parë, derisa rezultatin e barazoi Ermal Krasniqi. Në pjesën e dytë Ballkani vazhdoi dominimin dhe përmbysi rezultatin në minutën e 57-të, kurse edhe kësaj radhe shënues ishte Krasniqi. Në minutën e 74-të, Meriton Korenica realizoi për 1-3.

Vendasit në fund të ndeshjes realizuan golin e dytë me anë të Behar Maliqit, por që ishte i pamjaftueshëm për të marrë pikë. Ballkani me tri pikët e reja ngjitet në vendin e dytë me 15 pikë, kurse Malisheva renditet e teta me shtatë pikë të grumbulluara.

Flamurtari emëron Lecin trajner të juniorëve

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Liridon Leci që një vit është pjesë e Flamurtarit të Prishtinës. Ish-mbrojtësi i njohur është në rolin e ndihmëstrajnerit tek ekipi i parë, por tani ka marrë

një pozitë tjetër në klub. Kryeqytetasit i kanë besuar edhe rolin e trajnerit të parë në skuadrën e juniorëve. Tani Leci do t'i mbajë dy pozitat në klubin kryeqytetas,

ndihmëstrajner në ekipin e parë dhe trajner kryesor te juniorët. "Klubi ka vendosur që krahas punës në ekipin e parë si ndihmës, ta marrë edhe drejtimin e Juniorëve, një

mundësi e mirë për ta avancuar klubin dhe talentet e rinj. Falënderoj klubin për besimin dhe shpresoj ta bëjmë më të mirën!", ka thënë Leci për faqen zyrtare të klubit.



Rusia zyrtarisht e përjashtuar edhe nga 'Euro 2024'

NYON, 28 SHTATOR - Rusia nuk do të marrë pjesë as në Kampionatin Evropian që mbahet në vitin 2024 në Gjermani. Federata Ruse u përjashtua fillimisht nga Liga e Kombeve që u përmbyllë të martën mbërëma, ndërsa tani do të jetë jashtë garës më të madhe për përfaqësuese në Evropë. Tashmë

dihet se ky përjashtim vjen nga sulmet që Rusia i filloi më 24 shkurt të këtij viti ndaj Ukrainës. Kjo gjendje po vazhdon edhe tani, andaj UEFA ka marrë vendim që të mos e lejojë federatën ruse të marrë pjesë në kualifikimet e "Euro 2024". Natyrisht se ky është një dëm i madh për futbollin rus, derisa edhe

lojtarët nuk guxojnë ta kundërshtojnë pushtimin që Vladimir Putini po tenton ta bëjë ndaj Ukrainës. Vlen të përmendet se Kosova dhe Shqipëria janë pjesë e këtyre kualifikimeve, të vendosura në vazone e katërt, respektivisht tre. Nga ky përcaktim i vazove, "dardanët" dhe "kuqezinjët" mund të jenë në të njëjtin



grup, short ky që nuk do të ishte i mirëpritur

Reja: Jemi rritur shumë, të ardhmen e vendosim me drejtuesit



TI RANË, 28 SHTATOR - Edi Reja vijon të përjetojë me qetësi gjithçka ndodh në Kombëtaren Shqiptare dhe pas barazimit zhgënjyes ndaj Islandës, drejtoi gishtin nga mungesat, duke gjetur sërish një shkak për dështimin. Tekniku u shpreh se Shqipëria është rritur nën drejtimin e tij, por në vitin e fundit ka vuajtur mungesat e rëndësishme dhe gabimet e shpeshta të individëve.

Çfarë emri do t'i vinit barazimit me Islandën?

Reja: Ishim në epërsi numerike dhe duhej të menaxhonim mirë ndeshjen, por nuk arritëm ta mbyllnim dhe më pas dihej që ata ishin më të fortë fizikisht. U zëvendësua Gjasula, sepse nuk ndihej mirë, por vetëm pak çaste më pas u dëmtua Ismajli dhe ne nuk kishim më zëvendësime. Kishim edhe mungesa të shumta, gati 7-8 lojtarë të rëndësishëm. Ata që luajtën dhanë më të mirën, por në fund mund të fitonim, nëse do të tregonim pak kujdes. Më vjen shumë keq, pasi e flakëm tutje këtë ndeshje dhe vijmë të flasim

këtu për të njëjtat gjëra.

E keni nisur me Islandën dhe e mbyllni me Islandën, në pritje për të mësuar për të ardhmen tuaj. A mund t'i vendosni një notë përvojës tuaj te Shqipëria?

Reja: Nga ndeshja e parë me Islandën jemi rritur ndjeshëm, por natyrisht që këto kohët e fundit nuk kemi bërë shumë mirë. Kemi pasur mungesa të shumta të lojtarëve me eksperiencë, pro në total kemi bërë një rrugëtim të mirë. Së fundi skuadra nuk është përgjigjur në nivelin e pritshmërive.

Si ndiheni kur skuadra vërshtëllet në fund të ndeshjes? Jemi në fund të kontratës, si do të jetë e ardhmja?

Reja: Më vjen shumë keq për vërshtëllimat. Nuk e di, pasi kam kontratë deri në nëntor dhe më pas do të ulemi të flasim me presidentin. Do të diskutojmë dhe do të gjejmë zgjidhje për të ardhmen. Unë mendoj se kemi bërë një punë të mirë gjatë kësaj kohe, duke dhuruar edhe paraqitje të mira, por në kohët e

fundit nuk kemi dhënë atë që mundeshim, këtu përfshij edhe veten time. Kemi pasur shumë mungesa dhe nuk kemi qenë aty ku duhet. Megjithatë t'i lëmë justifikimet, pasi kemi aktivizuar shumë të rinj, funksionalë për skuadrën dhe lojën e saj.

Cikalleshi tha se është gati të largohet i pari për ta ndihmuar skuadrën të dalë nga kjo situatë...

Reja: Unë nuk kam asnjë keqardhje, pasi kam bërë një punë të mirë dhe jam munduar të ndihmoj skuadrën. Nuk jam unë problemi i Shqipërisë, pasi po të ishte kështu, presidenti do të ma kishte thënë. Unë jam munduar të përmirësoj qoftë individët, qoftë skuadrën. Ne ishim në epërsi numerike dhe duhej të mbyllnim ndeshjen, por nëse kjo nuk ndodh, atëherë nuk është faji im. Ata kanë bërë 5 gjuajtje dhe katër prej tyre në kuadrat. Ne kemi bërë 22 gjuajtje dhe vetëm 4 në kuadrat, ndaj nëse nuk janë të zotët ta dërgojnë topin në rrjetë, nuk kam çfarë të bëj. Duhet të përmirësohemi në këtë aspekt.

SHKURT

Vazhdon interesimi i Milanit për Brojën

AC Milan synon t'i marrë shërbimet e sulmuesit shqiptar në Chelsea, Armando Broja, verën e ardhshme, teksa kuqezinjët janë në kërkim të një lojtari që do ta mbajë numrin 9 në fanellë, sipas raportimit nga "Calciomercato". Cilësitë teknike dhe struktura fizike e Brojës është e atillë që përshtatet në mënyrë të përkryer me filozofinë e futbollit të Milanit. Për momentin nuk ka asgjë më shumë se një interesim i thjeshtë, por nuk mund të përjashtohet që mund të bëhet diçka më shumë në muajt në vijim. Maldini dhe Massara e kanë kuptuar se nuk mund të mbështeten vetëm tek Olivier Giroud, i cili së shpejti do të mbushë 36 vjet.

Ndryshime në Formulën 1, gjendet gjuha e përbashkët për garat Sprint

Drejtuësit e Formulës 1 kanë vendosur ta dyfishojnë numrin e garave të sprintit për sezonin e ardhshëm të kampionatit më të shpejtë në botën e automobilizmit. Krerët e botërorit të këtij sporti ranë dakord për ta çuar në gjashtë numrin e garave të sprintit për edicionin e 74-t të kampionatit të Formulës 1. Organizatorët e botërorit bashkë me drejtuesit e ekipeve kishin gjetur gjuhën e përbashkët për një ndryshim të tillë që në muajin prill, megjithatë gjithçka u shty për më vonë, për të marrë gjithashtu miratimin e presidentit të Federatës Ndërkombëtare të Automobilizmit Mohammed bin Sulayem.

Scaloni: Messi si Federeri, ta shijojmë sepse vështirë të shohim diçka të tillë përsëri

Pas fitores 3-2 ndaj Xhamajkës, trajneri i Argjentinës, Lionel Scaloni, ka folur veçanërisht për Leo Messin. "Duhet të kënaqesh me Messin. Ai është si Federeri", ka thënë Scaloni. Leo bëri një lojë shumë të bukur, ndërsa shënoi dy gola në sfidën miqësore ndaj Xhamajkës dhe Scaloni e krahasoi me fenomenin zviceran që sapo doli në pension: "E pamë të dilte në pension dhe të gjithë qanim. Kur Leo të dalë në pension, e njëjta gjë do të ndodhë. E vetmja gjë që ka mbetur për Messin është ta shijojmë sepse nuk e di nëse diçka e tillë do të ndodhë përsëri. Unë do të paguaja një biletë, do të blija çdo fanellë që ai ka mbajtur..." ka deklaruar Scaloni.

Atletico interesohet për Piquen

Mbrojtësi Gerard Pique mund të largohet nga "Camp Nou" në afatin kalimtar të janarit, pasi e ardhmja e tij te Barcelona është e pasigurt. 35-vjeçari ka luajtur mbi 600 herë për klubin, duke qenë një lojtar i jashtëzakonshëm i klubit, duke i ndihmuar ata të fitojnë tetë tituj të La Ligës, tre tituj të Ligës së Kampionëve dhe shumë gara të tjera. Gazeta spanjolle "OKDiario" pretendon se Atletico Madridi është i interesuar për lojtarin, me Diego Simeonen që dëshiron të shtojë një mbrojtës me përvojë në skuadrën e tij.

Kante rikthehet nga lëndimi

Pas ndeshjeve në Ligën e Kombeve në fundjavë do të rikthehen ndeshjet e kampionateve evropiane. Të gjitha kampionatet do të nisin me ndeshjet e tyre këtë fundjavë, ndërsa një lajm pozitiv ka marrë trajneri i Chelseas, Graham Potter, përpara sfidës së radhës në Premierë Ligë. Mesfushori N'golo Kante është rikuperuar nga lëndimi që mori në derbin ndaj Tottenham Hotspurit. Titullari i skuadrës do të jetë i gatshëm për sfidën ndaj Crystal Palaces dhe Potteri mund të bazohet te përvoja e francezit në mesfushë.

Barça zgjedh stadiumin për sezonin e ardhshëm, vetëm me 59 mijë vende

BARCELONË, 28 SHTATOR - "Camp Nou" do t'i nënshtrohet rikonstruksionit sezonin e ardhshëm dhe Barcelona ka vendosur që ndeshjet si pritëse t'i zhvillojë në "Estadio Olímpic

de Montjuic". Stadiumi provizor ka një kapacitet maksimal prej 59 mijë vendesh, nga të cilat 45 mijë do të jenë të rezervuara për abonentët dhe pikërisht këtu nis problemi. Në

"Camp Nou", Barcelona ka aktualisht 83 mijë tifozë të abonuar dhe do të jetë e pamundur që t'i kënaqë të gjithë, me një stadium që ka kapacitet shumë më të vogël. 83

mijë tifozë do të blejnë gjysmë abonim, pra një pjesë do ta ndjekin gjysmën e ndeshjeve si pritës në kampionat dhe një pjesë që do të mund ta ndjekin gjysmën tjetër.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr.1383/1
Datë:28.09.2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, shpallë këtë:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës të Kompetencës

1. Qendra e Kompetencës në Prizren;

Lloji i Vendit të Punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Koeficienti: 8.4
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin e efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për përzgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunësve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmeve tjera të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton se paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomati e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;

- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

II. Titulli i vendit të punës: Zëvendës Drejtor në Qendrën e Kompetencës në Prizren

1. Qendra e Kompetencës në Prizren;

Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,
Kategoria Funktionale: Nivel drejtues
Koeficienti: 7.8
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Zv. Drejtori , është përgjegjës për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave.
- Zv. Drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin të të ardhurave;
- Organizimin e kurseve të hapura për punonjësit të ndërmarrjeve të komunitetit lokal;
- Organizim e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të papunëve për tregun e punës në bashkëpunim me zyrën e punësimit;
- Organizimin e panairëve për prezantimin e produkteve të kompanive private dhe publike;
- Dhënie me qira të zyrave me të gjitha pajisjet për bizneset private; ,
- Ofrim të shërbimeve këshilluese për ish nxënësit e ndërmarrjeve lokale;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimin dhe punësimit të të gjithë nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit;
- Motivimin për nxënien për të rritur-personeli dhe prindërit;
- Siguron trajnime dhe aftësim që përshtaten nevojave të tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. drejtori i shkollës, menaxhon kohën për t'i arritur objektivat organizatave;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të identifikoj problemet e mundshme dhe mundësit;
- Zv. drejtori i shkollës, siguron që hapësirat e shkollës, pajisjet dhe sistemi mbështetës të funksionojnë në mënyrë efektive dhe efikase;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës , përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënësve;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master nga fushat Ekonomis, kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomati e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

Titulli i vendit të punës: Zëvendësudrejtor në Qendrën e Kompetencës në Prizren**III. në Qendrën e Kompetencës në Prizren****2. Qendra e Kompetencës në Prizren;****Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë****Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,****Kategoria Funktionale: Nivel drejtues****Koeficienti: 7.8****Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet****Qëllimi i vendit të punës:**

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Zv. Drejtori është përgjegjës për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. Drejtori i shkollës, kujdeset dhe është përgjegjës për zhvillimin e arsimit dhe bashkëpunimin me donatorët dhe institucione rajonale dhe të BE-së,
- Kujdeset për zhvillimin dhe aftësimin pedagogjik dhe profesional të mësimitdhënësve,
- Motivon stafin e mësimitdhënësve që të involvohen në bashkëpunim ndërkombëtarë,
- Kujdeset dhe është përgjegjës për krijimin e grupeve për hartimin e projekteve për institucione ndërkombëtarë,
- Është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në hartimin e projekteve me AAAPAR-në,
- Kujdeset për arritjen në shtetet e BE-së në sferën e AAP-së dhe në përshtatjen e tyre për nevojat e shkollës,
- Bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë për përgatitjen e nxënësve për tregun e jashtëm,
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për biznes;
- Zv. drejtori i shkollës, bën matjen dhe vlerësimin: Vlerësimin për të nxënë dhe Vlerësimin e të nxënë;
- Zv. drejtori i shkollës, është i obliguar që të mbaj komunikim të vazhdueshëm me palët e ndryshe të interesit;
- Zv. drejtori i shkollës, avokon për mbështetjen e komuniteti për shkollë dhe sistem më të gjerë të arsimit;
- Zv. drejtori i shkollës, inkurajon dhe modelon nxënësin gjatë gjithë jetës për nxënësit dhe personelin;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të shfrytëzoj burime të ndryshme të informatave për vendimet të cilat ndikojnë në mirëqenien e nxënësve në shkollë ;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të njeh mundësit e teknologjisë së re dhe asaj në zhvillim, dhe bën të mundur integrimin e tyre të plot në mbështetje të mësimitdhënës dhe të nxënies;

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim ne arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim ne arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimore (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimitdhënës sipas udhëzimit për licencim të mësimitdhënës;
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

Dokumentet e domosdoshme:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimitdhënës ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

Shpallja e Konkursit

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Adresa: Rruga "Agim Ramadani" 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAAPARr-së.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e shpalljes nga dt. 29.09.2022 deri me dt. 13.10.2022.

Pas përgatitjes së listës së ngushtë të kandidatëve, këtyre kandidatëve do të ju kërkohen kopjet e dokumenteve të vërtetuara nga organi kompetent (diploma dhe kontrata e punës ose vërtetimi i përvojës e punës) nëse ato nuk janë dorëzuar të vërtetuara.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkua sipas kushteve të konkursit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Br.1383/1
Datum:28.09.2022

Na osnovu Zakona br. 04/L-032 ua preduniverzitetsko obrazovanje u Republici Kosovo, na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, Zakona o stručnom obrazovanju i osposobljavanju 04/L-138, na osnovu člana 4 stav 2 tačka 2.3 Administrativnog uputstva MONT-a br.

151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora Javne obrazovne i preduniverzitetske ustanove u Republici Kosovo, Procedure izbora i imenovanja, raskidu ugovora i privremenom imenovanju, Administrativno uputstvo 05/2012, Administrativno Uputstvo 14/ 2014, Agencija APOOOO, objavljuje ovaj:

K O N K U R S
ZA POPUNJAVANJE RADNIH MESTA

Agencija za profesionalno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje za odrasle

I. Naziv radnog mesta: Direktor Centra Kompetencija**1. Qendra e Kompetencës në Prizren;****Tip radnog mesta: Na određeno vreme, sa punim radnim vremenom****Broj pozicija: Jedna (1) pozicija****Funkcionalna kategorija: Menadžerski nivo****Koeficijent: 8.4****Trajanje imenovanja: Četiri (4) godine****Namena radnog mesta:**

Rukovođenje, upravljanje i nadzor obrazovne ustanove

GLAVNE POSLOVNE DUŽNOSTI :

- Upravljanje i opšta uprava javne ustanove;
- Izrada godišnjeg plana rada i plana razvoja obrazovne ustanove i godišnjih izveštaja o radu;
- Efikasno i efektivno korišćenje sistema za upravljanje informacijama u obrazovanju i poštovanje kodeksa ovog sistema, procedura osiguranja i rokova za ažuriranje potrebnih podataka tokom školske godine;
- Dužnosti dodeljene za izbor nastavnika, vrednovanje, disciplina u obrazovnoj ustanovi i druga pitanja vezana za nastavnike i druge radnike u obrazovanju;
- Podrška i nadzor nad sprovođenjem nastavnog plana i programa;
- Podrška i nadzor nad radom aktiva i stručnih saradnika obrazovne ustanove, kao i drugih mehanizama obrazovne ustanove koji imaju ulogu u vrednovanju rada i upravljanju kvalitetom rada ustanove;
- Sarađuje sa upravnim savetom obrazovne ustanove (US), Savetom roditelja, Nastavničkim većem, Većem učenika i zajednicom obrazovne ustanove;
- Izveštava najmanje dva puta godišnje pred US;
- Obezbeđuje bezbedno i podsticajno okruženje za decu/učenike, uključujući dodeljivanje i primenu disciplinskih mera prema učenicima, u skladu sa zakonima na snazi;
- Čuvanje dokumenata i podataka, kako ih obezbeđuje opština ili Ministarstvo prosvete i nauke (MPNTI);;
- Ostala pitanja koja su regulisana zakonom o preduniverzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima usvojenim od strane MPNTI.

Uslovi:

- Da budu državljani Republike Kosovo;
- Da imaju završeno fakultetsko obrazovanje na nivou: Magistar iz oblasti rukovođenja, administracije ili menadžmenta u obrazovanju (kvalifikacija od 300 ECTS, najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- Magistar obrazovanja (kvalifikacija od 300 ECTS/5 godina univerzitetskog obrazovanja); - Četvorogodišnji (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog obrazovanja) – Četvorogodišnji Bachelor (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog obrazovanja);
- Da imaju stručnu pripremu relevantnih profila;
- Da imaju redovnu nastavničku licencu prema uputstvu za licenciranje nastavnika;
- Da su uspešno završili akreditovani program profesionalne kvalifikacije za rukovođenje, administraciju ili upravljanje u obrazovanju, na osnovu standarda profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, odobrenih od MPNTI prema preporukama KSHLM;
- Da imaju najmanje 5 godina radnog iskustva u obrazovnom procesu;

Potrebna dokumentacija:

- Diplome fakulteta završene za odgovarajući nivo kvalifikacije;
- Potvrde o uspešno završenom programu obuke za rukovođenje, administraciju ili menadžment u obrazovanju (u nedostatku potvrda o obuci za rukovođenje u obrazovanju, kandidat daje dokaz o zvanju Magistra rukovođenja);
- Lična dokumenta (izvod iz matične knjige rođenih i lična karta ili pasoš);
- Dokaz da ima nastavničku licencu ili da je u postupku licenciranja;

- Zdravstveno uverenje izdato u poslednjih šest meseci od licencirane zdravstvene ustanove koje dokazuje njegovo zdravstveno stanje;
